



ARTMOTION

Valon SHALA

Pronar

Prishtinë

Rasti Nr. 2018/43

Ref:1807/797/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2018/43 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për ARTMOTION ("Pala Përgjegjëse")

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM me datën 4 prill 2018 ka pranuar një ankesë të parashtruar nga operatori i shpërndarjes IPKO ndaj Palës Përgjegjëse, duke pretenduar se Pala Përgjegjëse ka ritransmetuar ngjarjen sportive të futbollit Shqipëri-Norvegji me datën 26 mars 2018 duke filluar nga ora 19:00 nëpërmjet kanalit TVSH. Ankesës i janë bashkangjitur edhe provat audiovizuale.
3. KPM përmes një shkrese me datën 4 prill 2018 e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga IPKO dhe e ka udhëzuar që brenda tre ditësh të ofrojë sqarim me shkrim si dhe të ofrojë dëshmi shtesë për të drejtën e ritransmetimit të ngjarjes sportive të lartpërmendur.
4. KPM me datën 10 prill 2018 ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse përmes së cilës potencohet se ata posedojnë kontratë valide për kanalin TVSH dhe se derisa nuk kanë pranuar asnjë njoftim për ndërprerjen e ritransmetimit për atë periudhë kohore, ata kanë ritransmetuar pa ndërprerje.
5. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 11 prill 2018 ka gjetur se Pala Përgjegjëse përmes kanalit TVSH ka ritransmetuar pa marrëveshje valide ngjarjen futbollistike të lartpërmendur.

6. KPM pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 20 prill 2018 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01, duke e ndërprerë menjëherë shpërndarjen e mëtutjeshme të përmbajtjes ilegale për të cilat nuk posedon të drejta valide të transmetimit dhe të ndërmarrë masa urgjente që një gjë e tillë të mos përsëritet. Po ashtu, në Njoftim është paralajmëruar që dështimi për të vepruar në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01 edhe pas Njoftimit për Shkelje, me automatizëm do të rezultojë me inicimin e procedurave ligjore në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

Analiza Ligjore

7. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 5, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2016/01.

Neni 5, paragrafi 2, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“I licencuari ka përgjegjësi për të garantuar se të gjitha shërbimet e programit të shpërndara përmes sistemit të tij të shpërndarjes janë në përputhje me Ligjin për KPM-në dhe aktet nënligjore që rregullojnë fushën përkatëse.”

8. Komisioni i KPM-së konstaton se duke u bazuar në Raportin e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të ardhur në pajtueshmëri me nenin 5, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2016/01.
9. Komisioni i KPM-së gjen se edhe përkundër faktit se Pala Përgjegjëse ka siguruar marrëveshje valide për kanalën TVSH, megjithatë ka dështuar të ndërmarrë veprime konkrete sa i përket kontrollit të përmbajtjes së këtij kanali, duke mos e errësuar kanalën gjatë transmetimit të ngjarjeve për të cilat një subjekte tjetër ka siguruar të drejtat për territorin e Kosovës.
10. Prandaj Komisioni i KPM-së duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura vlerëson se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 5, paragrafi 2 të Rregullores KPM-2016/01.

Vendimi

11. Komisioni i KPM-së gjen se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 5, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2016/01.
12. Komisioni i KPM-së, bazuar në nenin 30 paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, merr vendim që Pala Përgjegjëse të sanksionohet me **Vërejtje**, për shkelje të nenit 5, paragrafi 2 të Rregullores KPM-2016/01.

E drejta për Ankesë

13. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Muja FERATI

Kryetar



10.07.2018
Datë